



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Durrës

VITI 2019

Tabela e Përmbajtjes

MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	3
GJETJET KRYESORE	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË DURREËS.....	4
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019	6
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	6
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	14
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	21
REKOMANDIME.....	22

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019.

Gjetjet kryesore

- Nga data 01.01.2019 deri në datë 31.12.2019 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë regjistruar 250 kërkesë padi me objekt lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrotjes.
- Nga data 01.01.2019 deri në datë 31.12.2019 pranë kësaj Gjykate janë regjistruar 705 kërkesë padi me objekt zgjidhje martesë.
- Nga data 01.01.2019 deri në datë 31.12.2019 pranë kësaj Gjykate janë regjistruar 65 çështje penale për akuzën Dhunë në familje, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.
- Për vitin 2019 buxheti i bashkisë Durrës për shërbimet shpenzuar për viktimat e dhunës në familje është 1.235.470 lekë prej të cilave 545,000 lekë i buxhetohen Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” përmes 3 zërave: 1). ndihmë ligjore; 2). ndihmë psikologjike dhe 3). linja telefonike; ndërsa pjesa tjetër shërben për të mbuluar pagat për 3 nëpunëse të Barazisë Gjinore (NBGj) që paguhen specifikisht nga buxheti i bashkisë Durrës dhe që përveç punëve të tjera të profilit kanë edhe përgjegjësitë e Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje: Drejtoresha e Shërbimit Social dhe 2 Specialiste për barazinë gjinore e dhunën në familje specifikisht një për Bashkinë Durrës dhe një për Njësinë Administrative Sukth.
- Mekanizmi i Referimit në mbledhjet e organizuara ka trajtuar 19 raste të dhunës në familje.
- Mekanizmi i referimit në Bashkinë Durrës është mbledhur periodikisht çdo muaj, nga muaji janar deri në muajin dhjetor 2019, gjithsej 9 mbledhje të mekanizmit dhe 1 mbledhje e Komitetit Drejtues. Takimet e MKR-së vazhdojnë të organizohen bashkarisht me ato të GTN-së.
- Roli i koordinatorit vendor të MKR-së përgjatë periudhës Janar- Gusht 2019 vazhdon të jetë i mbivendosur me funksione pranë Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë. Për këtë shkak koordinimi i rasteve është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoresha e Shërbimit Social Meme Xhaferaj, Specialistja e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve Olta Bajraktari (Dedej) si dhe specialistja e barazisë gjinore Njësia Administrative Sukth. Po ashtu edhe mbledhjet e përmuajshme të MKR-së janë drejtuar nga specialistët e sipërpërmendur.
- Koordinatorin vendor të MKR-së Aurora Hyka ka ushtruar në mënyrë të plotë funksionet e veta përgjatë periudhës Shtator 2019, duke drejtuar dhe mbledhjen e këtij muaji.
- Prej Tetorit 2019 Bashkia Durrës nuk ka më një Koordinator për Dhunën në familje, pasi koordinatorja vendore, largohet nga ky pozicion duke marrë postin e drejtuesit të Drejtorisë së Shëndetit Publik, Durrës.
- Në kuadër të ndrryshimeve në Ligjin Nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” aktorët e mekanizmit të referimit si të Bashkisë Durrës po

ashtu dhe të Njësive Administrative janë trajnuar në Workshop-in me temë “Informimi dhe diskutime mbi ligjin Nr. 47/2018 (ndryshimet në Ligjin e Dhunës) dhe sfidat në zbatimin e tij”. Ky trajnim është organizuar në datat 10 dhe 17 Prill 2019, në kuadër të Projektit “Qendra Sociale për gra dhe vajza”, zbatuar nga SHGPS me financimin e AWEN/ SIDA.

- Në kuadër të luftës kundër dhunës në familje, janë zhvilluar 41 takime ndërgjegjësuese. Numri i pjesëmarrësve në takimet ndërgjegjësuese të realizuara në Njësitë Administrative të qytetit dhe periferisë, si dhe takimet me gjimnazistët dhe studentët, në total ka qenë rreth 880 pjesëmarrës.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Durrës

Të dhëna statistikore nga Gjykata e rrethit Durrës¹

Përgjatë vitit 2019 pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës janë regjistruar 250 kërkesë padi me objekt lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrotjes dhe 705 kërkesë padi me objekt zgjidhje martese. Ndërkohë që përgjatë 12 muajve të 2019-tës, pranë kësaj Gjykate janë regjistruar 65 çështje penale për akuzën Dhunë në familje, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal.

Të dhënat e disagreguara sipas gjinisë, arsimit, vendbanimit nuk janë vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për shkak të mënyrës së përpunimit. Të dhënat e hedhura në faqen online të gjykatës nuk janë plota.

Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë, Bashkia Durrës²

Në Shqipëri numërohen në terma absolut 3.414 gra që raportojnë dhunë. Përqindja më e lartë e grave që raportojnë dhunë në familje, është përqëndruar në qarkun e Tiranës me 37,2 % gra të dhunuara, ndjekur më pas nga qarku i Durrësit me 14,3 % me rritje krahasuar me një vit më parë. Nëse do shprehnim numrin e grave që raportojnë dhunë në raport me numrin e popullsisë së tyre, norma më e lartë e grave të dhunuara paraqitet në qarkun e Durrësit me 34,1 nga 32 që raportojnë para një viti shprehur për 10 mijë banorë.³

Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Durrës ka në përbërjen e saj 3 komisariate: Komisarjati i Policisë Durrës, Krujë e Shijak dhe 3 stacione policore: Fushë Krujë, Manzë dhe Plepa Plazh. Të gjitha të dhënat mblidhen e përpunohen në Drejtorinë Vendore të Policisë së qarkut Durrës. Ndërkohë që sipas statistikave të komisarjatis qendër në bashkinë Durrës, gjatë vitit 2019 janë evidentuar gjithsej 583 raste të dhunës në familje, ku 585 ishin personat e dëmtuar nga të cilat 464 ishin gra dhe vajza. Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar.

¹ Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

² Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

³ http://ëëë.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf

Gjatë vitit 2019 janë depozituar 418 kërkesë padi për lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes pas 583 rasteve të evidentuara. Ndërkohë që 117 raste janë vepra penale sipas nenit 130/a, me 20 autorë të arrestuar, 88 autorë që ndiqen në gjendje të lirë, dhe 8 autorë të shpallur në kërkim, 6 autorë të ndaluar

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Durrës

Përshkrimi	Komisariati Durrës
Evidentuar	583
Të dëmtuar gjithsej	585
Prej tyre gra/vajza	464
Kërkesë për U.Mbrojtje	418
Shkelje U.Mbrojtjes	14
V. P. Neni 130/a	117
Arrest. për 130/a	20
Ndaluar për 130/a	6
Gjendje të Lirë për 130/a	88
Në kërkim për 130/a	8
Autorë të vetëvrarë	1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit

Ndërkohë që përgjatë periudhës 12 mujorë të 2019-tës, Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në Familje pranë bashkisë Durrës ka trajtuar 19 raste të vajzave dhe grave të dhunuara, duke i ofruar kryesisht këshillim ligjor dhe psikologjik, përfaqësim në Gjykatë në proceset për pajisjen me UMM dhe UM si dhe kallëzimet për vepra penale të parashikuara nga neni 130/a i kodit penal “Dhunë në familje”.

Ajo që vihet re gjatë këtij viti është fakti që 7 prej rasteve të trajtuara në mbledhjet e mekanizmit janë referuar për akomodim në Qendrën Kombëtare të Strehimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Kamëz. Nga këto 7 raste, në tre prej tyre viktimat ka refuzuar akomodimin në këtë qendër, duke u rikthyer në familjen e origjinës ose tek bashkëshorti, duke mbajtur procesverbalet përkatëse në momentin e mospranimit apo largimit nga qendra. Një rast i cili ka shkuar personalisht për tu akomoduar në qendër nuk është pranuar pasi nuk e provon situatën e dhunës dhe e ka referuar pranë Koordinatorës Vendore të Dhunës në Bashkinë Durrës.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Nga monitorimi i zbatimit të strategjisë në vijimësi rezulton se rolin kryesor në fushatat ndërgjegjësuese në bashkinë e Durrësit e kryejnë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) që punojnë në territorin e bashkisë.

Në mungesë të një buxheti specifik të përcaktuar për fushata ndërgjegjësuese, bashkia Durrës ka koordinuar punonjësit e saj, konkretisht specialistët e barazisë gjinore dhe ndihmës ekonomike dhe Drejtorinë e Shërbimit Social Durrës, që në bashkëpunim me OSHC-të të implementojnë projekte kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore në territorin e bashkisë së Durrësit.

Përsa më sipër janë realizuar takime ndërgjegjësuese në bashkëpunim me:

- QZHK “Sot për të Ardhmen”, që buxhetohet nga bashkia Durrës në ofrimin e tre shërbimeve për viktimat e dhunës: 1) ndihmë ligjore; 2) ndihmë psikologjike dhe 3) linja telefonike;
- Shoqatën e Grave me Probleme Sociale Durrës, sot Shoqata “Gender Paqe e Siguri” me të cilën Bashkia ka marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projekteve të implementuara nga Shoqata.
- Qendra Fokus- Në Ndihmë të Fëmijëve
- World Vision, përmes programeve për familjen dhe fëmijët.

Në takimet ndërgjegjësuese dhe mbledhjet e aktorëve të GTN e MKR-së janë të përfshirë dhe organizata të krishtera, siç është World Vision. Kjo e fundit është mbështetës në çdo mbledhje të GTN-së dhe mbetet donatori kryesor për edukimin e familjes dhe të një sërë temash për dhunën.

Për vitin 2019 buxheti i Bashkisë Durrës për shërbimet shpenzuar për viktimat e dhunës në familje është 1.235.470 lekë prej të cilave 545,000 lekë i buxhetohen Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” përmes 3 zërave: 1) ndihmë ligjore; 2) ndihmë psikologjike dhe 3) linja telefonike; ndërsa pjesa tjetër shërben për të mbuluar pagat për 3 nëpunëse të Barazisë Gjinore (NBGj) që paguhet specifikisht nga buxheti i Bashkisë Durrës dhe që përveç punëve të tjera të profilit kanë edhe përgjegjësitë e Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje: Drejtoresha e Shërbimit Social dhe 2 Specialiste për barazinë gjinore e dhunën në familje specifikisht një për bashkinë Durrës dhe një për Njësinë Administrative Sukth.

Numri i pjesëmarrësve në takimet ndërgjegjësuese në total gjatë vitit 2019 ishte 880 pjesëmarrës (nga aktivitetet e realizuara nga SHGPS në kuadër të projektit “Qendra Sociale për gra dhe vajza” mbështetur financiarisht nga AËEN/SIDA, Projekti “Bashkë për komunitetet të qëndrueshme dhe edukim” mbështetur nga Qendra Fokus në Ndihmë të Fëmijëve, si dhe Projektit “ Të drejtat e grave nga koncepti në realitet” – Rezoluta 1325 e OKB- financuar nga UN Women, FGE), ku grupet e targetuara janë gra dhe fëmijë të familjeve me probleme sociale. Këto aktivitetete janë zhvilluar në:

- Zonën e Spitallës;

- Porto Romano;
- Kënetë;
- Nishtulla;
- Shkozet;
- Gra të Njësive Administrative Sukth, Manëz, Katund i Ri, Rrashbull - Bashkia Durrës;
- Nxënës të Shkollave të mesme në Njësitë Administrative dhe Bashkinë Durrës;
- Administratorë Socialë pranë Bashkisë Durrës dhe Njësive Administrative;
- Anëtarë të mekanizimit të referimit në Njësitë Administrative dhe Bashkinë Durrës.

Organizatave e Shoqërisë Civile të përfshira në koordinimin e aktiviteteve dhe fushatave ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore në Bashkinë e Durrësit përgjatë vitit 2019 janë:

1. QZHK “Sot për të Ardhmen”;
2. Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës - Shoqata Gender, Paqe e Siguri;
3. Qendra “Fokus në ndihmë të fëmijëve”;
4. World Vision.

QZHK “Sot për të Ardhmen”

Kjo organizatë buxhetohet nga Bashkia Durrës në ofrimin e 3 (tre) shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. E pozicionuar në rrethinat e qytetit të Durrësit, në zonën e Kënetës, ajo ofron:

1. Këshillimi psikosocial i viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe në familje përmes Numrit të Gjellbër **08009888**. Ky është një shërbim që ofrohet 24 orë, çdo ditë dhe falas nga një staf multidisiplinar dhe profesionist.
2. Këshillim juridik dhe psikologjik ballë për ballë për viktimat dhe dhunuesit.
3. Mbështetje dhe këshillim ligjor përsa i përket UMM dhe UM në Drejtorinë Vendore të Policisë, Prokurori, Gjykatë, Zyrë Përmbarimi.

Shoqata e Grave me Probleme Sociale – Shoqata “Gender, Paqe e Siguri”

SHGPS në kuadër të projektit “Qendra Sociale për Gra dhe Vajza” të financuar nga AWEN/Sida përgjatë vitit 2019 ka ofruar këshillim ligjor dhe psikologjik për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Këshillimi psikologjik është bërë ballë për ballë për të gjithë gratë e vajzat e paraqitura vetë apo të referuara nga aktorët e mekanizimit, numri në total i të cilëve shkon në 254 raste.

Po ashtu është ofruar dhe ekspertiza psikologjike përmes asistimit të 3 rasteve në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës kur të pranishëm në aktin e dhunës kanë qënë dhe fëmijët, 1 rast UMM në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, zgjidhje martesë 8 raste.

Shërbimi tjetër i ofruar për viktimat e dhunës është dhe ai i këshillimit ligjor për 160 raste në total deri në Shtator 2019, të dsagreguara si më poshtë:

164 këshillime të drejtpërdrejta, 18 përpilim kërkesë padish, 12 pë rfaqë sime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me objekt zgjidhje martesë si pasojë e dhunës dhe UMM, 4 përfaqësime në procedime penale pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, 5 raste kërkesa ankimore dhe erfaqesim, 7 kërkesa drejtuar Zyres së Përmbarrimit për ekzekutimin e vendimeve, 2 procedura legalizimi të banesave, 3 raste të marrjes së sendeve vetjake nga banesa bashkeshortore dhe 23 raste ndihme në hapjen e portalit qeveritar E-Albania.

Në kuadër të po këtij projekti janë mbajtur dhe takime ndërgjegjësuëse me banorë dhe nxënës të Gjimnazeve dhe shkollave profesionale në Durrës dhe Njësitë Administrative Sukth, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz ku fokusi kryesor ishte dhuna në familje, ndryshimet në ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligji për "Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti" si dhe dhuna në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve. Përfitues të këtyre takimeve ishin 585 persona.

Përveç këtyre organizatave në fokus të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, është dhe Klinika e Ligjit pranë Universitetit Aleksandër Moisiu. Shërbimet ligjore ofrohen ndaj shtresave vulnerabël, kryesisht në çështjet ku procesi i kundërdrejtohet një organi të administratës publike si dhe çështje të litigimit strategjik.

Nga ana e disa prej aktorëve të Mekanizmit si Drejtoria Rajonale Arsimore, Spitali Rajonal Durrës dhe Drejtoria e Shëndetit publik nuk raportohet që të jenë paraqitur pranë tyre, të kenë identifikuar apo referuar raste të dhunës në marrëdhëniet familjare. Mungesa e raportimit prej tyre dhe në anën tjetër identifikimi i tyre si aktorë që kanë dhënë ndihmën e tyre si pjesë të mekanizmit, sjell një përplasje statistikash. Kjo pasi nga në çdo rast të kallëzimeve penale për dhunë në familje viktimat e ka pasur të domosdoshëm paraqitjen para mjekut ligjor dhe Spitalit Rajonal Durrës. Në të tilla kushte arrihet në konkluzionin se këta aktorë nuk mbajnë një databazë të dhënash për rastet e evidentuara apo shërbimet e ofruara viktimave të dhunës në familje.

Ndërkohë nga Zyra Shtetërore Përmbarrimore Durrës referohet se ka pasur 2 raste vendime UMM të regjistruara pranë kësaj zyre për vënien në ekzekutim⁴ pranë kësaj bashkie. Në vijim kjo zyrë ka ekzekutuar 631 raste me objekt "pension ushqimor" dhe 110 raste me objekt "takim fëmijë".

Ajo që vazhdon të paraqitet ende si problematikë është fakti Gjykata nuk i përcjell drejtpërdrejt këto vendime për ekzekutim në Zyrën e Përmbarrimit. Këto vendime mund të paraqiten vetëm personalisht me kërkesë të palës kreditore që përkon me viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare.

E njëjta situatë ndodh edhe me Shërbimin e Provës Durrës përgjatë vitit 2019. Asnjë nga aktorët e mekanizmit nuk ka referuar raste të dhunës në familje, në zbatim të urdhërimeve të dhëna me Vendimet e UMM dhe UM .

Ky institucion edhe pse punon drejtpërdrejt me dhunuesit, vazhdon të mos të jetë aktor në Mekanizmin e Durrësit.

Përsa i përket Dhomës së Avokatisë Durrës, edhe pse parashikimi i VKM-së Nr. 334 datë 17.2.2011 " Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në

⁴ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit

marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” është që ky aktor duhet të jetë pjesë e mekanizmit, nuk është i përfshirë. Edhe në marrëveshjen e re të bashkëpunimit të nënshkruar në Shator 2019, Dhoma e Avokatisë Durrës dhe Zyra e Shërbimit të Provës nuk janë të përfshira.

Shoqata e Grave me Probleme Sociale në kuadër të projektit “Qendra Sociale për Gra dhe Vajza” të mbështetur nga AWEN/SIDA në datat 10 dhe 17 Prill 2019 ka organizuar workshop me aktorët e MRDHF me temë “Informimi dhe diskutime mbi ligjin Nr. 47/2018 (ndryshimet në Ligjin e Dhunës) dhe sfidat në zbatimin e tij”.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1.	29.01.2019	Shkolla e Mesme “Olsi Lasko”	“Bashkë për komunitete të qëndrueshme dhe edukim”	SHGPS; Qendra Fokus-Në ndihmë të fëmijëve”
2.	13.02.2019	Shkolla e Mesme “16 Shatori” Shijak	“Bashkë për komunitete të qëndrueshme dhe edukim”	SHGPS; Qendra Fokus-Në ndihmë të fëmijëve”
3.	26.02.2019	Njësia Administrative Rrashbull	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhma Juridike e garantuar nga shteti“	SHGPS, AWEN/SIDA
4.	27.02.2019	Spitallë, Durrës	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhma Juridike e garantuar nga shteti“	SHGPS, AWEN/SIDA
5.	28.02.2019	Njësia Administrative Sukth	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhma Juridike e garantuar nga shteti“	SHGPS, AWEN/SIDA
6.	04.03.2019	Gjimnazi “Naim Frashëri”	„Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë”	SHGPS, AWEN, Suedi Sverige
7.	04.03.2019	Porto Romano Durrës	“Fushatë ndërgjegjësuese “Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006”	ShGPS, AWEN, Suedi Sverige
8.	08.03.2019	Sheshi para Bashkisë Durrës	Protesta e zisë, protesta e zërit	ShGPS, AWEN, Suedi Sverige, Qendra Konsumatori Shqiptar

9.	18.03.2019	Qendra Komunitare Kënetë	Të gjitha bashkë mund të ndryshojmë realitete	QZHK “Sot për të Ardhmen”
10.	18.03.2019	Gjimnazi Katund i Ri	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti“	SHGPS, AWEN /SIDA
11.	20.03.2019	Njësia Administrative Manëz	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti“	SHGPS, AWEN /SIDA
12.	22.03.2019	Shkozet	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti“	SHGPS, AWEN /SIDA
13.	10.04.2019	Restorant “Splendid” Durrës	Workshop me aktorët e MRDHF “Informimi dhe diskutime mbi ligjin Nr. 47/2018 (ndryshimet në Ligjin e Dhunës) dhe sfidat në zbatimin e tij	ShGPS, AWEN, Suedi Sverige
14.	15.04.2019	Njësia Administrative Sukth	Fushatë ndërgjegjësuese “Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006”	ShGPS, AWEN /SIDA
15.	16.04.2019	Njësia Administrative Manëz	Fushatë ndërgjegjësuese “Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006”	ShGPS, AWEN /SIDA
16.	17.04.2019	Restorant “Splendid” Durrës	Workshop me përfaqësues të njësive administrative si aktorët e MRDHF “Informimi dhe diskutime mbi ligjin Nr. 47/2018 (ndryshimet në Ligjin e Dhunës) dhe sfidat në zbatimin e tij	ShGPS, AWEN, Suedi Sverige
17.	19.04.2019	Njësia Administrative Katund i Ri	Fushatë ndërgjegjësuese “Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006”	ShGPS, AWEN /SIDA

18.	09.05.2019	Njësia Administrative Rrashbull	Fushatë ndërgjegjësuese “Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006”	SHGPS, AWEN, Sida
19.	21-05-2019	Spitallë	Fushatë ndërgjegjësuese “Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006”	SHGPS, AWEN, Sida
20.	28.05-2019	Restorant Splendid Durrës	“Stop dhunës me bazë gjinore. Niveli i zbatimit të objektivit të 3-të të strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2016- 2020”	SHGPS, GADC
21.	28.05.2019	Shkozet	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006	ShGPS, AWEN/SIDA
22.	06.06.2019	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	“ Të rinjte dhe gratë në fushën e sigurisë e të paqes”	Shoqata “Gratë Paqja dhe Siguria”, UN Women
23.	19.06.2019	Njësia Administrative Manëz	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006	ShGPS, AWEN/Sida
24.	20.06.2019	Njësia Administrative Sukth	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006	SHGPS, AWEN/SIDA
25.	25.06.2019	Shkozet	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006	SHGPS, AWEN/SIDA
26.	12.07.2019	Njësia Administrative Rrashbull	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006. Dhuna në	SHGPS, AWEN/SIDA

			marrdhëniet intime në adoleshencë	
27.	23.07.2019	Katund i Ri	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë	SHGPS, AWEN/SIDA
28.	25.07.2019	Porto Romano	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë	SHGPS, AWEN/SIDA
28.	27.09.2019	Shkolla e Mesme Manëz	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë	SHGPS, AWEN/SIDA
29.	30.09.2019	Njësia Administrative Rrashbull	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë	SHGPS, AWEN/SIDA
30.	30.09.2019	Shkolla e Mesme „Beqir Cela“	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë	SHGPS, AWEN/SIDA
31.	11.10.2019	Hotel Palace Durrës	Shkëmbim eksperiencash mes aktorëve të MKR Bashkia Durrës dhe përfaqësues të 13 bashkive të reja.	UNDP, Bashkia Durrës
32.	17.10.2019	Porto Romano, Durrës	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhurma Juridike e garantuar nga shteti“	Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës, SIDA, AWEN
33.	25.10.2019	Shkolla e Mesme Sukth	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhurma Juridike e garantuar nga shteti“	Shoqata e Grave me Probleme Sociale Durrës, SIDA, AWEN

34.	25.10.2019	Shkolla e Mesme "Katund i Ri"	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti"	SHGPS, AWEN/SIDA
35.	13.11.2019	Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës	Barazia gjinore në sektorin audioviziv në Shqipëri	UAMD, GADC
36.	20.11.2019	Njësia Administrative Manëz	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti"	SHGPS, AWEN/SIDA
37.	17.12.2019	Njësia Administrative Rrashbull	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti"	SHGPS, AWEN/SIDA
38.	18.12.2019	Shkozet	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti"	SHGPS, AWEN/SIDA
39.	19.12.2019	Njesia Administrative Sukth, Kulle	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti"	SHGPS, AWEN/SIDA
40.	19.12.2019	Njesia Administratitve Katund i Ri	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti"	SHGPS, AWEN/SIDA
41.	23.12.2019	Porto- Romano, Durres	Takim Ndërgjegjësues Dhuna në familje, Ndryshimet në ligjin Nr. 9669/2006.Dhuna në marrdhëniet intime në adoleshencë, Ndhima Juridike e garantuar nga shteti"	SHGPS, AWEN/SIDA

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanzimi i referimit në Bashkinë Durrës për vitin 2019 është mbledhur periodikisht çdo muaj, nga muaji Janar e në vijim janë mbajtur gjithsej 9 mbledhje të mekanizmit dhe një mbledhje të Komitetit Drejtues. Këto takimet vazhdojnë të jenë të përbashkëta së bashku me GTN-në.

Edhe këtë vit nuk ka pjesëmarrje të plotë të të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje. Mungojnë, veçanërisht institucione të rëndësishme që punojnë drejtpërdrejtë me viktimat dhe dhunuesit, të tilla si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; Zyra e Përmbarimit Shtetëror Durrës; Zyra e Punës Durrës. Këto institucione më së shumti nuk marrin pjesë në takime dhe nuk kanë koordinim me institucionet e tjera, veçanërisht me Bashkinë, sa i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.

Takimi i GTN për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë mbrojtje bëhet i përbashkët me takimin e mekanizmit kundër dhunës, ashtu siç vërehet edhe nga lista e pjesëmarrësve, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët mbledhjet duhet të zhvillohen bashkë. Ndërkohë koha që u kushtohet secilës prej mbledhjeve është jo e barabartë, pasi takimi i GTN sipas planifikimit dhe zbatimit zgjat rreth 2 orë ndërsa takimi i MKR-së i planifikuar për një orë zgjat nga 20 minuta deri në 1 orë.

Për vetë kohëzgjatjen e të dy takimeve, pjesa më e madhe e përfaqësuesve të institucioneve largohen me përfundimin e takimit të GTN, i cili është dhe takimi i parë në axhendë. Kjo sjell mos funksionimin e MKR-së, pasi mbledhja në vetvete realizohet por koordinimi mes të gjithë aktorëve mungon. Mbledhja e MKR-së nuk drejtohet nga nënpunësi i barazisë gjinore por nga Përgjegjësja e Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe me raste nga specialistja e barazisë gjinore, Njësia Administrative Sukth.

Roli i nëpunësit të barazisë gjinore, përgjatë vitit 2019, (janar – gusht) ishte i mbivendosur me funksione të tjera në bashki që nuk kanë të bëjnë me çështje të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore. Për rrjedhojë, shpesh herë përgjigjia kundër dhunës me bazë gjinore kalon në plan të dytë.

Koordinatori ka qënë plotësisht në funksionin e tij vetëm përgjatë muajit Shtator 2019 duke e drejtuar dhe një prej mbledhjeve të zhvilluara.

Raporti i përmuajshëm i minutave të takimit nuk u nda asnjëherë nga Koordinatorja e MKR-së por nga Specialistja e Barazisë Gjinore Njësia Administrative Sukth, Mihane Pashnjari.

Sistemi i hedhjes të të dhënave “Revalb” në lidhje me statistikën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e specialistes

së barazisë Gjinore për Njësinë Administrative Sukth, sa herë që nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës komunikohen vendimet e UMM dhe UM.

Përsa i përket përqindjes së buxhetit që i dedikohet funksionimit të MKR-së ai është sa ½ e pagës së ditës së punës, duke mos patur të përcaktuar buxhet tjetër.

Nga të dhënat e monitorimit vihet re gjithashtu se për funksionimin e mekanzimit përgjatë vitit 2019 buxheti alokon pagën e Koordinatorit Vendor të Dhunës. Pozicioni i Koordinatorit Vendor është krijuar që prej vitit 2007 dhe prej fillimit ka qënë e punësuar znj. Aurora Hyka. Aktualisht (tetor) pas largimit të saj nga detyra, pozicioni i saj i punës mbetet bosh dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës nuk është hapur ende thirrja për konkurim.

Funksionet e koordinatorës aktualisht është duke i realizuar Inspektorja për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje e Njësisë Administrative Sukth znj. Mihane Pashnjari, e cila e kryen punën e saj 3 ditë në Sukth dhe 2 ditë në Durrës.

Bashkia Durrës ka të parashikuar buxhet për dhunën vetëm përmes buxhetimit që i bëhet QZHK "Sot për të ardhmen" për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës. Po ashtu, paguan 3 punonjës për Dhunën, Kordinatorin Vendor, Drejtoreshën e Shërbimit Social dhe Inspektoren e barazisë gjinore dhe dhunës në familje në masën e 1.235.470 lekë.

Ndërkohë Bashkia Durrës nuk ka të përcaktuar në buxhetin e saj zë të vecantë për realizmin e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, për publikimin e fletëpalosjeve ndërgjegjësuese apo materiale të tjera të ngjashme.

Bashkia Durrës bashkëpunon me Drejtorinë Vendore të Policisë Qarku Durrës në referimin e rasteve të dhunës në familje. Ky bashkëpunim provohet me numrin e rasteve të menaxhuara si dhe me rastet e shoqërimit të viktimave në Strehëzën Kombëtare të Dhunës në Kamëz, Tiranë.

Për të vijuar me Drejtorinë Arsimore Rajonale, e cila ka një bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Durrës me qëllim me qëllim realizmin e fushatave ndërgjegjësuese për familjen dhe fëmijët. DAR është e pranishme në cdo takim të realizuar pranë Bashkisë Durrës si pjesë e GTN-së dhe MKR-së.

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të MRKDHF-së ne vitin 2019 në Bashkinë Durrës

Viti	Mbledhjet e MRKDHF
28.01.2019	Mbledhja u zhvillua në ambjentet e Qendrës së Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar" Lagia 17, pranë UKD(Durrës), me pjesëmarrjen e 16 personave, aktorë të mekanizmit. Takimi ka qënë i përbashkët, mes aktorëve të Grupit Teknik Ndërsektorial dhe Grupit të Reagimit të Kordinduar Kundër Dhunës në Familje. Takimi u zhvillua në dy pjesë, nga ora 10:30 deri në orën 12:00 u mbajt takimi i GTN, nën drejtimin e specailistes të NJMF-së, ku u diskutuan disa nga rastet e paraqitura në

	<p>Bashkinë Durrës.</p> <p>Takimi i mekanizmit kundër dhunës nisi në orën 12:00 deri në orën 13:10. Kjo mbledhje u drejtua nga specialistja e dhunës në familje pranë Njesisë Administrative Sukth si dhe Olta Dedej Specialistja e NJMF Bashkia Durrës.</p>
18.03.2019	<p>Takimi i MKR u mbajt më datë 18.03.2019 në ambjentet e Qendrës së Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar" Lagia 17, pranë UKD(Durrës), me pjesëmarrjen e 6 personave, aktorë të mekanizmit.</p> <p>Kjo mbledhje është zhvilluar vetëm për Grupin e Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje.</p> <p>Mbledhja ishte planifikuar të niste në orën 11:00, por për shkak të mungesës të antarëve u shty deri në orën 11:30 dhe zgjati deri në orën 11:45. Ky takim u drejtua nga specialistja e dhunës në familje pranë Njesisë Administrative Sukth dhe Bashkisë Durrës, ku u diskutuan disa nga rastet e paraqitura në Bashkinë Durrës dhe në SHGPS.</p>
26.04.2019	<p>Takimi i MKR u mbajt më datë 26.04.2019 në ambjentet e Qendrës së Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar" Lagia 17, pranë UKD(Durrës), me pjesëmarrjen e 15 personave, aktorë të mekanizmit dhe GTN-së.</p> <p>Kjo mbledhje është zhvilluar e përbashkët për Grupin e Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje dhe GTN-në.</p> <p>Mbledhja e GTN-së nisi në orën 10:30 dhe vazhdoi deri në orën 12: 00 duke u trajtuar vetëm raste të GTN-së.</p> <p>Takimi i MKR-së nisi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 12:07.</p> <p>Ky takim u drejtua nga specialistja e dhunës në familje pranë Njesisë Administrative Sukth dhe Bashkisë Durrës. Pjesëmarrëse gjatë këtij takimi ishin përfaqësues të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës, Njësia Mbrojtjes së Fëmijëve, Sukth, Bashkia Durrës, DAR Durrës, ZRP Durrës, Zyra e Punës, Durrës, SHGPS, DRSH Durrës, Qendra e Shërbimeve Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar" , NJ.M.F Bashkia Durrës</p>
24.05.2019	<p>Takimi i MKR u mbajt më datë 24.05.2019 në ambjentet e Sallës së Konferencave, Qendra Tregtare "Blue Star" Durrës, me pjesëmarrjen 14 personave, aktorë të mekanizmit dhe GTN-së.</p> <p>Kjo mbledhje është zhvilluar e përbashkët për Grupin e Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje dhe GTN-në.</p> <p>Mbledhja e GTN-së nisi në orën 10:30 dhe vazhdoi deri në orën 12: 20 duke u trajtuar vetëm raste të GTN-së.</p> <p>Takimi i MKR-së nisi në orën 12:20 dhe përfundoi në orën 13:00.</p> <p>Ky takim u drejtua nga specialistja e dhunës në familje pranë Njesisë Administrative Sukth dhe Bashkisë Durrës. Pjesëmarrëse gjatë këtij takimi ishin përfaqësues nga Q.Sh.M "Drejt Zhvillimit", DRSH Durrës, Njësia vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, Bashkia Durrës, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Q.K.M. Nishtulla, Njësia Mbrojtjes së Fëmijëve, Sukth, DAR Durrës – Shkolla "Hysen Cela", SHGPS, Shërbimi Social Bashkia Durrës, GADC.</p>
12.06. 2019	<p>Është zhvilluar nje takim mes aktoreve te Mekanizmit dhe kandidatet per zgjedhjet vendore ne Bashkine Durres per subjektin politik Partia Socialiste, Valbona Sako.</p> <p>Per kete mbledhje nuk jemi njoftuar nga Koordinatorja dhe organizatoret prane Bashkise Durres, por nga nje nga aktoret e Mekanizmit, Zyra e Permbarimit.</p>

	<p>Duke qene se jemi vene ne dijeni te mbledhjes pasi kishte perfunduar, nuk kemi arritur qe te jemi te pranishem.</p> <p>Pas kontaktit te realizuar me Specialisten e Barazise Gjinore, Mihane Pashnjari, informohemi se takimi ishte kerkuar qe te realizohej nga ana e Valbona Sako-s dhe me organizmin e takimit ishte marre vete Drejtoresha e Sherbimit Social Shteteror, Meme Xhaferraj.</p> <p>Takimi ishte mbajtur nga ora 10:00 deri ne oren 10:30 ne Zyrat e Sherbimit Social Bashkia Durrës, me pjesmarrjen vetem te institucioneve pjese te Mekanizimit.</p> <p>Per pjesen e diskutimeve ne prezantim/mbledhje nuk kemi asnje informacion tjetër.</p>
31.07.2019	<p>Mbledhja e aktorëve të MKR-së, u mbajt në sallën e konferencave, Blue Star Durrës. Takim u mbajt i përbashkët mes aktorëve të GTN dhe MKR-së.</p> <p>Ne takim ishin te pranishem, perfaqesues nga aktorët e mëpsotëm: <i>QKMN, Qendra Komunitare e Fëmijëve me Aftësi Ndryshme, TDH, Psikologe Klinike, DVPQ Durrës, Bashkia Durrës, NJVKSH, Drejtorja Shërbimit Social, Bashkia Durrës, SHGPS Durrës.</i></p> <p>Takimi nisi në orën 12:00 e vijoi për rreth 30 minuta, nën drejtimin e specialistes së NJMF Bashkia Durrës.</p>
20.09.2017	<p>Ky takim u mbajt në ambientet e Sallës së Konferencave, Hotel Harmonia, Golem, Kavajë, me pjesmarrjen 14 personave, aktorë të mekanizmit dhe GTN-së.</p> <p>Kjo mbledhje është zhvilluar e përbashkët për Grupin e Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje dhe GTN-në.</p> <p>Mbledhja e GTN-së nisi në orën 11:00 dhe vazhdoi deri në orën 12: 40 duke u trajtuar vetëm raste të GTN-së.</p> <p>Takimi i MKR-së nisi në orën 12:40 dhe përfundoi në orën 13:50.</p> <p>Ky takim u drejtua nga Kordinatorja e Dhunës në Familje në Bashkinë Durrës. Pjesmarrëse gjatë këtij takimi ishin përfaqësues nga:</p> <p>Bashkia Durrës, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, SHGPS, Psikologe DAR, Drejtorja Vendore e Policisë Durrës, Terre Des Hommes, NJMF Bashkia Durrës, Njësia Mbrojtjes së Fëmijëve, Sukth, Bora Bahiti – Eorl Vision</p> <p>Gjate takimit u diskutuan 5 raste nga Kordinatorja e Dhunës në Familje, Bashkia Durrës. Pjesmarrja e shumë antarëve në takim lidhet vetëm me takimin e GTN-së. Edhe në këtë takim vihej re mungesa e Gjykatës, Prokurorisë, Sherbimit të Proves, Zyrës së Përmbarrimit si dhe OJF QZHK “Sot për të ardhmen”.</p> <p>E rëndësishme për tu theksuar është fakti i rikthimit me kohë të plotë në funksionin e saj të Koordinatorës të Dhunës në familje pranë Bashkisë Durrës.</p>
31.10.2019	<p>Kjo mbledhje u mbajt në zyrat e Drejtorisë së Shërbimit Social, pranë Ish URT-së, mbledhja e MRKKDHF. Kjo mbledhje është zhvilluar e përbashkët për Grupin e Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje dhe GTN-në.</p> <p>Takimi i MKR-së nisi në orën 12:00 dhe përfundoi në orën 13:00.</p> <p>Ky takim u drejtua nga Specialiste e Dhunës dhe Barazisë gjinore NJ.A Sukth dhe Bashkia Durrës.</p> <p>Pjesmarrëse gjatë këtij takimi ishin përfaqësues nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, ZVA Durrës, Drejtorja Vendore e Policisë Durrës, NJ.M.F Bashkia Durrës, Bashkia Durrës, NJ.A Sukth, QKMN, QSHKPAK</p>

	<p>Gjate takimit u diskutuan 2 raste.</p> <p>Edhe në këtë takim vihej re mungesa e Gjykatës, Prokurorisë, Sherbimit të Proves, Zyrës së Përmbartimit si dhe OJF QZHK “Sot për të ardhmen”.</p> <p>Në këtë takim mungon Koordinatorja e Dhunës në familje, pasi është emëruar si Drejtor i Shëndetit Publik, Durrës.</p> <p>P.S Për këtë mbledhje njoftuar në datë 29.10.2019 përmes e-mailit, duke informuar se mbledhja GTN-së dhe MKR-së do të bëhej bashkë.</p>
19.12.2019	<p>Kjo mbledhje u mbajt në ambjentet e Qendres "Shërbime Komunitare për Fëmijet me Aftësi të Kufizuar", Lgji 17. Pranë ujësjellësit Durrës.</p> <p>Kjo mbledhje është zhvilluar e përbashkët për Grupin e Reagimit të Kordinuar Kundër Dhunës në Familje dhe GTN-në. Takimi i MKR-së nisi në orën 12:30 dhe përfundoi në orën 13:00. Ky takim u drejtua nga Specialiste e NJMF Olta Bajraktari, në mungese të specialistes Mihane Pashnjari, specialiste kundër Dhunës dhe Barazisë gjinore NJ.A Sukth dhe Bashkia Durrës. Pjesmarrëse gjatë këtij takimi ishin përfaqësues nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, ZVA Durrës, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, NJ.M.F Bashkia Durrës, Bashkia Durrës, QKMN, QSHKPAK. Gjate takimit nuk u diskutuan raste të reja. Edhe në këtë takim vihej re mungesa e Gjykatës, Prokurorisë, Sherbimit të Proves, Zyrës së Përmbartimit si dhe OJF QZHK “Sot për të ardhmen”. Në këtë takim mungon Koordinatorja e Dhunës në familje, pasi është emëruar si Drejtor e Shëndetit Publik, Durrës.</p> <p>P.S Për këtë mbledhje njoftuar në datë 18.12.2019 përmes e-mailit, duke informuar se mbledhja GTN-së dhe MKR-së do të bëhej bashkë.</p>

Burimi: Monitorim i drejtpërdrejtë

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të KD-së Bashkinë Durrës 2019

Viti	Mbledhjet e KD
2019	<p>Në datë 11.10.2019, në Sallën e Konferencave të Palace Hotel Durrës, u mbajt mbledhja e Komitetit Drejtues të Mekanizimit të Koordinuar kundër Dhunës në Familje në Durrës.</p> <p>Ky aktivitet u organizua nga Bashkia Durrës me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të projektit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Ti japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatohet nga UNDP, UN WOMEN dhe UNFPA.</p> <p>Mbledhja nisi në 10:30 nën drejtimin e Drejtoreshës së Sherbimit Social Durrës, Z. Meme Xhaferraj, në pjesëmarrjen e Znj. Merita Xhafaj, Drejtore e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të SHëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – MSHMS, Znj. Limya Eltayeb, përfaqësuese e përhershme e UNDP Shqipëri.</p> <p>Aktorët e pranishëm në takim ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Valbona Sako- Kryetar Bashkisë Durrës 2. Lorenc Shehu - Drejtor Vendor PQD 3. Fabiola Egro- QZHK “Sot për të ardhmen” 4. Evelina Balliu- Mjeke Shëndeti Durrës 5. Alina Mema - Zyra e Punës Durrës

6. Rezarta Agolli –SHGPS
7. Arjana Lito – Zyra e Përmbartimit Durrës
8. Oltjana Cifligu- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës
9. Petrit Sulati- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Durrës
10. Migena Muhaj- Drejtore Eorld Vision Durrës
11. Erjeta Alhysa – ZVA Durrës

Po ashtu, të pranishëm në takim ishin dhe përfaqësues të 10 (dhjetë) Bashkive të reja, për të lidhur marrveshjet e bashkëpunimit me UNDP për ngritjen dhe funksionimin e MKRS-së.

Në fjalën e saj Kryetarja e Bashkisë Durrës, vuri theksin te orientimi i politikave që mvështesin familjen dhe zhvillimin e saj. Limya Eltayeb- përfësqsuese e Përhershme e UNDP Shqipëri vlerësoi arritjet e deritanishme të MKR-së Durrës, duke theksuar se kjo ishte Bashkia e parë e cila krijoi MKR-në për të luftuar dhunën në familje. Cështja e dhunës kundër grave i përket të gjithë botës e duhet luftuar. Ajo theksoi faktin që duhet rritje kapacitetesh të burimeve njerëzore si dhe buxhet për fushata e programe për viktimat e dhunës në familje.

Merita Xhafaj në fjalën e saj tha se është ngritur një model suksesi për qëndrën e emergjencës për dhunën seksuale, brënda spitalit Nënë Tereza Qendra Liliuim“. Ajo i kërkoi si Bashkisë së Durrësit e po ashtu bashkive të reja që do të ngrenë MKR-të, hedhjen në kohë të të dhënave në sistemin REVALB , pasi sipas saj ka disa koordinatorë që nuk e bëjnë, hezitojnë, rëndësinë e lëshimit të urdhërit paraprakë të mbrojtjes, mospranimi i pajtimit në momentin e denoncimit, kushtimi i një rëndësie të vecantë fëmijëve viktimat të dhunës në familje, ose të pranishëm në aktin e dhunës.

Secili nga aktorët e pranishëm mori fjalën gjatë takimit, duke u prezantuar dhe duke theksuar se bashkëpunimi mes tyre do të vazhdojë të forcohet duke i dhënë viktimave të gjithë mbështetjen e duhur në riintegrimin e tyre në Shoqëri.

Gjatë takimit, disa prej drejtuesve të MKR-së nënshkruam marrveshjen e rifreskuar të bashkëpunimit, për shkak të ndryshimeve të drejtuesve të institucioneve, aktorë të MKR-së.

Më pas, nga ana e Drejtoreshës së Shërbimit Social Durrës, u prezantua mënyra e funksionimit të MKR-së Durrës, disa arritje të saj, sfidat që hasin në punën e përditshme, si dhe vijimësinë e fushatave e takimeve ndërgjegjësuere të organizuara nga Bashkia Durrës me mbështetjen e OJF-ve.

Në fjalën e saj, Edlira Papavangjeli – koordinatorë Kombëtare e programit të PNUD, theksoi se: “ndryshimet në ligjin e dhunës kanë sjellë ndikime pozitive, por kërkojnë më shumë bashkëpunim mes koordinatorëve vendor dhe policisë shtetit. Duhet bërë vlerësim i rrishtit, nëse do jepen masa UPM apo do dërgohet dosja për UMM në Gjykatë. Ne kemi mbështetur si PNUD për zyrën e ndihmës ligjore falas pranë gjykatës, e duam të rikthehemi sërish brënda ambjenteve të gjykatës Durrës, brënda këtij viti. Bashkëpunim më i mirë me administratorët shoqëror në cdo njësi, në mënyrë që viktimës ti ofrohen të gjitha shërbimet e nvojshme.”

Fabiola Egro – Drejtore e QZHK theksoi: “Kemi para sifda e problematika të mëdha, ofrimi i shërbimeve 24 orëshe nuk është i lehtë, por mundohemi që përmes programit për familjen të japim maksimumin tonë për viktimat e mundshme. Rasti i A.Shaholli, është një rast i vecuar, policia nuk bashkëpunoi në trajtimin e rastit ndaj patëm viktimat. Mkr- ja në Durrës ka punuar mirë por kemi të bëjmë me një popullsi heterogjene.

	<p>Falenderoj shumë koordinatorin Bashkinë Durrës duke qënë në koherencë, duke ardhur në terren e ndjekur rastet bashkë me ne. Na është përgjigjur shumë strehëza, shtëpia e fëmijës, spitali. Në këto kushte kërkojmë ngritjen me standarte të strehzës së emergjencës, buxheti dhe mbështetja e specializuar e aktorëve. Të llobojmë të rrisim më tepër buxhetin e bashkisë, të llobojmë me partnerët, për të riparë mudnësinë e mbështjetjes së mkr-së apo strukturave të vecanta në ofrimin e shërbimeve.“</p> <p>Gjatë takimit u vu re mungesa e përfaqësuesve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Zyrës së Shërbimit të Provës. Po ashtu në takim nuk ishte e pranishme Koordinatorin i MKR-së Durrës, Aurora Hyka.</p>
--	---

Burimi: Monitorim i drejtpërdrejtë

Tabela 6: Komiteti Drejtues i Bashkisë Durrës viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Vangjush Dako - Valbona Sako, Kryetar
Drejtoria e Policisë	Alfred Cepe – Lorenc Shehu- Drejtor
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Joana Qelesi
Prokuroria e Rrethit	Anita Jella
Drejtoria Arsimore Rajonale	Lindita Muka - Valentina Leka
Drejtoria e Shëndetit Publik	Kristo Huta – Aurora Hyka
Zyra e Përmbartimit	Ariana Lito
Prefektura	Roland Nasto
Zyra e Punës	Indrit Butka
QZHK “Sot për të Ardhmen”	Fabiola Egro
Shoqata e Grave me Probleme Sociale	Bajana Çeveli

Tabela 7. GTN-ja e Bashkisë Durrës viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Meme Xhaferaj Drejtore e Shërbimit Social Aurora Hyka, NBGj bashkia Durrës Mihane Pashnjari, NBGj Njësia administrative Sukth
Drejtoria e Policisë	Etleva Miri, Specialiste
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Viola Kondo, Kancelare
Prokuroria e Rrethit	Ne mbledhje nuk ka asnjë përfaqësues të institucionit.
Drejtoria Arsimore Rajonale	Psikologët sipas rasteve të trajtuara
Drejtoria e Shëndetit Publik	Arjola Roshi, Psikologe Nexhmije Balla
Zyra e Përmbartimit	Iva Kujovsa, Durim Balla
Prefektura	Nuk është e pranishme në asnjë mbledhje
Kryetarët e Njësive Administrative	Nuk janë të pranishëm

Zyra e Punësimit	Marilda Gusmari Brunilda Kuci
Organizata Jo qeveritare	1. Fabiola Egro (QZHK) Viola Cikalleshi 2. Bajana Cevoli (ShGPS) Aurora Kondakciu
Strehëzat për viktimat e dhunës	Nuk ka
Komunitete fetare	Nuk janë të pranishme
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk janë të pranishme

Burimi: Monitorim i drejtpërdrejtë

Në bazë të Ligjit Nr. 9669 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, plotësimi i Urdhërave Paraprak të Mbrojtjes, UMM dhe UM është detyrë e Drejtorisë Vendore të Policisë Qarku Durrës, Prokurorisë Durrës përmes padisë publike, çdo avokat si dhe OJF.

Ajo që ndodh zakonisht është plotësimi i tyre vetë nga ana e DVP Qarku Durrës. Kjo ndodh kryesisht për disa arsye. Së pari, me plotësimi e kërkesë padisë për UMM policia merr edhe deklaratimet e secilës palë, viktimës dhe dhunuesit, çka e bën dosjen më të plotë procedurialisht, e më pas e dorëzon në Gjykatë. Ndërkohë plotësimi i të njëjtës padie nga avokati mbrojtës i viktimës, apo nga një OJF përmban vetëm deklarinimin e fakteve nga ana e viktimës/paditëses dhe jo të paditurit/dhunues. Nga praktika gjyqësore UMM e plotësuara nga avokatët apo OJF në mbrojtje të grave shihen si të paplota dhe paragjykohe.

Sipas të dhënave të marra nga Gjykata Durrës, për vitin 2019 Bashkia Durrës nuk ka plotësuar asnjë UMM apo UM.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës kryesisht disponon në vendim me nenin 10/1 a, b, c, d, ç, f të Ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Asnjë nga masat e dhëna nuk parashikojnë programe rehabilitimi për dhunuesin, pasi Bashkia Durrës nuk disponon asnjë program të tillë. Në qytetin e Durrësit nuk ka as organizata joqeveritare që kanë programe të tilla.

Asnjë UM apo UMM nuk shkon në zyrën e përmbarrimit direkt nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ndonëse ka qënë dhe është detyrim i ligjit: Neni 19 (i ndryshuar) pika 5 "Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim."

Gjykata e rrethit Gjyqësor Durrës i publikon të dhënat e saj mbi rastet e ndjekura në gjykatë në mënyrë të detajuar në faqen e saj në internet. Këto të dhëna janë të ndara sipas veprës penale apo civile, sipas kohëzgjatjes së marrjes së vendimit si edhe nëse rastet janë të paraqitura së fundmi apo të mbartura nga vitet e kaluara. Këto të dhëna nuk janë të disagreguara sipas gjinisë dhe nuk ka detaje sa i përket çështjeve të dhunës në familje, të cilat mbledhen kryesisht nga drejtoria e policisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka të dhëna të sakta statistikore për UMM të pëcaktuara sipas vendbanimit; qytet, periferi apo fshat, moshës, gjinisë, statusit civil, numrit të fëmijëve, nivelit arsimor, statusit të punësimit. Gjithashtu kjo gjykatë ka të dhëna të hollësishme mbi vendimin dhe faktin nëse kërkesa për UMM është pranuar hedhur poshtë apo pushuar. Gjykata mban statistikë të lidhjes familjare të viktimës me dhunuesin, nëse viktimja ka marrë asistencë nga qendrat e specializuara dhe të faktit nëse është paraqitur ndonjëherë në institucione shtetërore për kërkimin e ndihmës. Nuk publikohen online të dhënat e UMM, ato dalin veç në shortin ditor, gjithashtu nuk publikohen online vendimet UMM.

Shërbimi i Provës është institucion i cili nuk përfaqësohet asnjëherë në mbledhjet e GTN. Përveç kësaj mungon edhe komunikimi midis koordinators dhe kësaj strukture sepse koordinatori nuk është në dijeni të rasteve të referuara të dhunuesve për t'u trajtuar me programe të tilla. Koordinatori nuk ka informacion mbi format e aplikuar të shërbimeve apo kohëzgjatjen e shërbimit. Shërbimi i Provës nuk është anëtar i Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe si i tillë nuk ka detyrim ligjor të raportojë pranë koordinators vendor. Mekanizmi i Referimit të dhunës ofron shërbime përmes institucioneve anëtare për viktimat e dhunës në familje, dhe jo për dhunuesit.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Durrësit për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Durrës dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandohet pjesëmarrje e plotë e të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje apo në aksione të koordinuara midis tyre. Veçanërisht është e domosdodhme prezenca dhe bashkëpunimi i institucioneve si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; Zyra e Përmbartimit Shtetëror Durrës; Zyra e Punës Durrës. Këto institucione më së shumti nuk marrin pjesë në takime dhe nuk kanë koordinim me institucionet e tjera, veçanërisht me Bashkinë, sa i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.
- Rekomandohet rishikimi i marrveshjes së bashkëpunimit mes aktorëve të MKR-së. Edhe pse e rirfirmosur si draft në muajin tetor 2019, ka mungesë të aktorëve të tillë si Dhoma e Avokatisë apo Shërbimi i Provës.
- Rekomandohet që pozicioni i koordinators vendor të plotësohet duke bërë fillimisht shpalljen e vendit bosh. Pozicioni i tij në koordinimin e mekanizmit është i rëndësishëm në menaxhimin dhe koordinim e rasteve të dhunës të paraqitura në këtë institucion apo të referuara nga institucionet e tjera.

- Koordinatorja i MKR-së përveç ndarjes së raporteve të përmuajshme duhet që të përcaktojë detyrat dhe shërbimet që ka nevojë viktimat e dhunës. Vetëm ndarja e minutave të takimit nuk i shërben ofrimit të shërbimeve apo riintegritetit të viktimës së dhunës në shoqëri.
- Rekomandohet planifikimi i një zëri buxhetor përsa i përket organizimit të fushatave e takimeve ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje e dhunës me bazë gjonore, në publikimin e fletpalosjeve ndërgjegjësuese.
- Asnjë nga masat e dhëna nga Gjykata e Rrethit nuk parashikojnë programe rehabilitimi për dhunuesin, pasi Bashkia Durrës nuk disponon asnjë program të tillë. Në qytetin e Durrësi nuk ka as organizata joqeveritare që ofrojnë programe të tilla për dhunuesit.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës duhet të shtojë në dispozitivin e vendimit të UMM dhe UM edhe detyrimin e Zyrës së Përmbartimit Shtetëror Durrës për vënien në ekzekutim të këtij vendimi. Në mungesë të një urdhërimi të tillë Zyra e përmbartimit si aktor i MKR-së ka funksion të zbehtë.
- Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Durrës duhet të zbatojë ndryshimet ligjore në Ligjin për dhunën, duke lëshuar Urdhërin Paraprak të Mbrojtjes. Në këtë mënyrë, gjendet një zgjidhje me efektive për viktimën e dhunës, duke e lënë të qendrojë në banesë e duke detyruar dhunuesin të largohet apo duke e referuar për në Strehëzen Kombëtare të Dhunës.
- Rekomandohet që Qendra e Emergjencës të vihet në funksion duke i ofruar mundësinë viktimave të dhunës të jenë të mbrojtura gjatë periudhës së lëshimit të UMM-së.